



PROKURORIA E PËRSHKURTIMIT

15/09/2026
02/256.



KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS
Komisioni Komunal i Aksionarëve

Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve”, SH.A. Malishevë, në mbledhjen e mbajtur më 14.09.2026, në përputhje me nenin 16 dhe 17 të Ligjit nr. 03/L-087 për “Ndërmarrjet Publike”, të datës 13 qershor 2008, shpall:

KONKURS

Pozita: Drejtor në Bordin e Drejtorëve të NPL “Stacioni i Autobusëve”, SH.A. Malishevë

Numri i pozitave: 4 (katër)

Kohëzgjatja e mandatit: 3 (tre) vjeçar

Vendi i punës: Malishevë

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

- Të respektojë ligjet, statutin e Ndërmarrjes, aktet tjera dhe të zbatojë vendimet e Komisionit Komunal në pajtueshmëri me ligjin.
- Përgatit dhe miraton strategjit afatgjate, poashtu miraton Planin e Punës, Raportin e punës dhe atë financiar.
- Emëron, largon apo zëvendëson Kryeshefin Ekzekutiv.
- Kryen mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi punën e biznesit të ndërmarrjes, mbi punën e Kryeshefit Ekzekutiv dhe zyrtarëve tjerë brenda ndërmarrjes.
- Siguron që sistemet adekuate të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë kontrollin financiar dhe procedurat, janë në nivelin e duhur.
- Për punën e vet Bordi i Drejtorëve i përgjigjet Komisionit të Aksionarëve dhe Kuvendit Komunal.

KUALIFIKIMET DHE PËRVOJA:

Kandidatët e suksesshëm për pozitën e Anëtarit të Bordit të Ndërmarrjes Publike Komunale duhet t'i plotësojnë kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe përshtatshmërisë profesionale, si vijon:

- Diploma e fakultetit dhe trajnime tjera relevante.
- Rekomandohet përvoja e punës.
- Të jetë person me integritet të dëshmuar i cili plotëson kushtet e parapara me dispozitat e nenit 17.1, 17.2, 17.3, 17.4 dhe 17.4a të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, përkatësisht Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 si dhe me Ligjin nr. 05/L-009.
- Njohuria e gjuhëve të huaja dhe e punës me kompjuter do të konsiderohen përparësi.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

- Me intervistë

KUSHTET TJERA:

Kandidatët për Drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve", SH.A. në Malishevë, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në
- Letër motivimin
- Diplomën e përgatitjes shkollore
- Dëshminë për përvojën e punës
- Deklaratën nën betim në të cilën deklaron se i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafit 1-3 të nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e përshtatshmërisë (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën që dëshmon se nuk është nën hetime për vepra penale dhe civile sipas nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
- Kopje të Letërnjoftimit ose Pasaportës së Republikës së Kosovës (që dëshmon se është shtetas i Republikës së Kosovës)

DORËZIMI I APLIKACIONIT:

- Dokumentacioni duhet të jetë në pliko të mbyllur, ku shënohet: Emri dhe Mbiemri i aplikantit, emri i NPK-së dhe të dorëzohet pranë zyrave të NPK "Stacioni i Autobusëve", SH.A. Malishevë, rruga "Adem Jashari" (përballë Stacionit të Policisë).

- Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Dokumentet origjinale mund të kërkohen gjatë intervistës.
- Aplikacionet e arritura pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të merren në shqyrtim nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve.
- Do të kontaktohen vetëm personat e përzgjedhur për intervistë.

KOMPENSIMI I DREJTORËVE TË BORDIT:

Kompensimi i Drejtorëve të Bordit të NPL “Stacioni i Autobusëve”, SH.A. bëhet në bazë të nenit 10 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe nenit 12 të Ligjit nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes e-mailit: komuna.malisheve@rks-gov.net

Afati i Konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit.

Malishevë, 14.09.2026

Kryesues i Komisionit Komunal të Aksionarëve:
Remzi Hoti